



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

BULETINI MUJOR I SEMUNDSHMERISE INFEKTIVE (Pasqyra 14 Sh)

SEKTORI I EPIDEMIOLOGJISE

KORRIK 2018

Buletini mujor i sëmundshmërisë infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Epidemiologjisë, Instituti i Shëndetit Publik. Ky buletin mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te. Ai plotësohet në pasqyrën në formatin EXCEL dhe dërgohet me postë elektronike dhe me poste zyrtare në DEKSI, Instituti i Shëndetit Publik, brenda datës 10 të çdo muaji. Te dhënat e agreguara të pasqyrës 14 sh për muajin Korrik janë të dhënat e raportuara nga të 36 rrethet e vendit.

1. Semundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjate muajit Korrik 2018 zënë 55.33% të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me ane të Pasqyrës 14 sh dhe paraqesin një incidencë 316.38/100.000 banorë. Dihet që periudha e muajve të nxehte të vitit mbart me vete frekuencën me të larte të episodeve diarreike dhe në muajin korrik vihet re një tendence në rritje e sëmundjeve diarreike ku peshën kryesore e mbajnë gastroenteritet e paspecifikuara me një incidencë për muajin Korrik 2018 në nivel kombëtar, 305.23/100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuar janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit.

Në muajin Korrik janë raportuar dy raste me Tifo abdominale, një pacient 23 vjeç banues në Sukth dhe një paciente nga një fshat i Pogradecit. Nga ana e DRSHP Durrës dhe DSHP Pogradec u morën masat përkatëse në vatër dhe koprokulturat e personave të kontaktit rezultuan negativ.

Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës jotifoide dhe Shigelozës për muajin Korrik 2018 në nivel kombëtar përkatësisht me incidencë 1.86/10.000 banorë dhe 2.65/10.000 banorë. Muaji Korrik ka mbartur dhe dy raste me Shigella sonnei nga e njëjta familje banues në Tiranë. Hetimi epidemiologjik nga DRSHP Tirane konstatoi ndotje mikrobike në ujin e rrjetit në ambientet e restorantit ku kishin konsumuar rastet dhe janë marra masat e përkatëse antiepidemike.

Ndërkohe që në nivel kombëtar toksikoinfeksionet alimentare paraqesin një incidencë 7.54/100.000 banorë. Rrethet Berat, Bulqizë, Kavajë, Kukës dhe Tirane mbajnë peshën kryesore në raportimin e toksikoinfeksioneve alimentare. Te gjitha rastet janë sporadike, nuk kanë patur lidhje epidemiologjike me njeri tjetrin dhe nuk kanë qenë pjesë e ndonjë shpërthimi me përjashtim të 11 rasteve të raportuara nga qyteti i Tiranës të cilat kanë qenë pjesë e një shpërthimi të shkaktuar nga konsumimi i suflaqeve në një fast-food në Tiranë.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidenat e sëmundjeve diarreike ne Korrik 2018 (Incidenca raste/100.000 banore)


	Raste, Korrik 2018	Incidenca Korrik 2018 (raste/100.000 banore)
Tifo abdominale + Paratifo	2	0.07
Salmonelozë	46	1.64
Shigeloze (Disenteri bacilare)	53	1.89
Dizenteri amebike	0	0
Toksikoinfeksione alimentare	211	7.54
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	8547	305.23
Semundje diarreike ne total	8859	316.38

2. Sëmundjet e EPI

2.1.Fruthi

Gjatë muajit Korrik 2018 në kuadrin e vazhdimësisë së epidemisë së fruthit janë dyshuar në total 80 raste prej të cilave janë konfirmuar me IgM pozitiv vetëm 36 raste. Rastet janë konfirmuar ne Laboratorin e Virologjisë, ne ISHP.

Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara për fruth sipas datës së fillimit të rashit, Korrik 2018



Peshën kryesore sipas shpërndarjes gjeografike të rasteve të dyshuara dhe të konfirmuara me fruth e mban Tirana, Kruja, Fieri dhe Durrësi.

2.2. Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit Korrik 2018 janë raportuar 24 raste me Tuberkuloz pulmonar dhe 6 raste me Tuberkuloz ekstrapulmonar, me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te. Vihet re nga te dhënat e ardhura ne ISHP që peshën me te madhe te rasteve me Tuberkuloz pulmonar e mban Tirana (11 raste), Laçi (5 raste), Dibra (3 raste), Lushnjë (3 raste), Elbasani (1 rast) dhe Durrësi (1 rast). Grupmosha e prekur është ajo adulte. Nga 24 raste te suspektuara 15 janë te konfirmuar me Tuberkuloz pulmonar dhe nëntë raste te suspektuara.

3. Zoonozat

Ne nivel vendi incidenca e Brucelozës është 0.39/100.000 banore. Rastet për muajin Korrik 2018 janë raportuar nga rrethet Lushnjë, Gjirokastër dhe Korçë. Gjatë muajit Korrik në pasqyrën 14 sh është raportuar një rast i konfirmuar me Antraks nga rrethi i Lushnjës i grupmoshës 20-24 vjeç.

Ndërkohë gjatë kësaj periudhe janë suspektuar pese raste dhe janë konfirmuar prej tyre vetëm dy raste me Leptospirozë.

Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike ne Korrik 2018 (Incidenca raste/100.000 banore)

	Raste, Korrik 2018	Incidenca Korrik 2018 (raste/100.000 banore)
Antraks (Plasje)	1	0.04
Brucelozë	11	0.39
Leptospirozë	5	0.18
Leishmaniaza viscerale	0	0
Leishmaniaza kutane	0	0

4. Hepatitet virale

Ne raportimin mujor te sëmundshmërisë infektive gjate muajit Korrik 2018 janë raportuar ne total 15 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.54/100.000 banore) nga te cilat 4 raste janë Hepatite virale të paspecificuar dhe 2 raste Hepatit viral akut A dhe 9 raste Hepatit viral B.

Ne lidhje me HBV, 9 rastet i përkasin grupmoshave: 35-34 vjeç (6 raste), 25-29 vjeç (1 rast), 35-39 vjeç (1 rast), dhe grupmoshës 65 + vjeç (1 rast). Katër raste janë nga Shkodra, dy janë raportuar nga Durrësi dhe një rast përkatësisht nga Tirana, Lushnja dhe Tropoja.

5. Meningoencefalite

Gjate muajit Korrik 2018 janë raportuar ne total 5 raste me meningoencefalite përkatësisht 2 raste me meningit bakterial jo meningokoksik te suspektuara dhe tre raste me meningjit viral aseptik. Predominon grupmosha e rritur. Rastet paraqiten me një shpërndarje gjeografike perkatesisht ne rrethet Tirane, Berat dhe Bulqizë.

6. Sëmundjet virale me vatra natyrore

Ethe hemorragjike virale: gjatë kësaj periudhe kemi raportimin e një rasti te dyshuar Ethe hemorragjike virale dhe te konfirmuar pranë laboratorit te virologjisë ne ISHP. Rasti 35 vjeç, mashkull, blegtor, banor ne Kuç, te rrethit te Skraparit në një largësi rreth 2 ore nga qendra. Theksohet prania e brejtësve rreth zonës se banimit dhe referon prezence dhe pickim nga rriqna. Rasti ka paraqitur klinike me temperature, ethe, dhimbje koke dhe dobësi për një periudhe 5 ditore deri ne momentin e hospitalizimit në Spitalin Infektiv ne QSUT ku është dyshuar për Ethe hemorragjike virale dhe Leptospirozë, nga ku rastit me pas i janë marre mostrat serike për diagnozën laboratorike pranë ISHP. Rasti rezultoi negativ për Leptospirozë dhe pozitiv për Ethe hemorragjike virale.

Hartoi: **Departamenti i Kontrollit te Sëmundjeve Infektive, Sektori i Epidemiologjisë.**

Silvia Bino, Eugena Tomini, Artan Simaku, Adela Vasili, Luljeta Alla, Elona Kureta, Rovena Daja, Marjeta Dervishi.

Editoi: Rovena Daja

INSTITUTI I
SHENDETIT PUBLIK

DEKSI